

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga 4iG Informatikai Zartkoruen Mukodo Reszvenytarsasag, shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rr. Montevideo nr. 2/C, 1037 Budapest, Hungari, i dorëzuar përmes Ivana Jeftiq Nikollovës, avokate nga Shoqëria e Avokatëve Toshiq dhe Jevtiq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 27.01.2026, mori këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin 4iG Informatikai Zartkoruen Mukodo Reszvenytarsasag, me seli të regjistruar në rr. Montevideo nr. 2/C, 1037 Budapest, Hungari, do të fitojë kontroll mbi FaceCom Korlatolt Felelossegu Tarsasag, me seli të regjistruar në rr. Szabadsag tér nr. 7, 1054 Budapest, Hungari dhe Mobil Adat Tavkozlesi es Informatikai Szolgaltato Korlatolt Felelossegu Tarsasag, me seli të regjistruar në rr. Montevideo nr. 3/B, kati III, hyrja 1, 1037 Budapest, Hungari, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 26.12.2025, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga 4iG Informatikai Zartkoruen Mukodo Reszvenytarsasag, shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rr. Montevideo nr. 2/C, 1037 Budapest, Hungari, me të cilin 4iG Informatikai Zartkoruen Mukodo Reszvenytarsasag do të fitojë kontroll mbi FaceCom Korlatolt Felelossegu Tarsasag, me seli të regjistruar në rr. Szabadsag tér nr. 7, 1054 Budapest, Hungari dhe mbi Mobil Adat Tavkozlesi es Informatikai Szolgaltato Korlatolt Felelossegu Tarsasag, me seli të regjistruar në rr. Montevideo nr. 3/B, kati III, hyrja 1, 1037 Budapest, Hungari, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim dhe dokumentacionit të bashkëngjitur, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira

4iG Informatikai Zartkoruen Mukodo Reszvenytarsasag ka si veprimtari kryesore programimin kompjuterik.

4iG Informatikai Zartkoruen Mukodo Reszvenytarsasag ka një person juridik të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe atë Shoqëria për Shërbime Komunikuese ONE MAQEDONIA TELEKOMUNIKACII SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Crvena Voda nr. 7/3, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, veprimtaria prioritare e së cilës janë veprimtaritë e telekomunikimeve pa tela.

FaceCom Korlatolt Felelossegu Tarsasag ushtron veprimtari në fushën e programimit kompjuterik.

FaceCom Korlatolt Felelossegu Tarsasag nuk është e pranishme në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mobil Adat Tavkozlesi es Informatikai Szolgaltato Korlatolt Felelossegu Tarsasag ka si veprimtari kryesore aktivitetet nga teknologjitë e tjera informatike dhe shërbimet kompjuterike.

Mobil Adat Tavkozlesi es Informatikai Szolgaltato Korlatolt Felelossegu Tarsasag nuk është e pranishme në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ